



UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT



Universiteti "Fan S. Noli"
FAKULTETI I EKONOMISË

ÛDHËZUES

**Për përgatitjen dhe mbrojtjen e Temës së Diplomës
në përfundim të ciklit të parë të studimit**

PROGRAMI I STUDIMIT "MENAXHIM"

BACHELOR





Universiteti "Fan S. Noli"
FAKULTETI I EKONOMISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
FAKULTETI I EKONOMISË
KORÇË

Adresa: Shëtitore "Rilindasit"

Tel/Fax: ++355 82 247800

Web: www.unkorce.edu.al

U D H Ë Z U E S

**Për përgatitjen dhe mbrojtjen e Temës së Diplomës
në përfundim të ciklit të parë të studimit**

PROGRAMI I STUDIMIT "MENAXHIM"

BACHELOR

VITI AKADEMIK 2019-2020



I. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME MBI TEZËN E DIPLOMËS

Teza e diplomës është pjesë e programit të studimit **Bachelor** dhe synon kompletimin me aftësi aplikative dhe profesionale. Teza e diplomës është disiplinë e kategorisë **E** dhe vlerësohet me **7 kredite**. Për t'u pranuar në mbrojtjen e temës, studenti duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit, pra të ketë marrë **173 kredite**. Për të fituar Diplomën Bachelor, studenti duhet të japë provën finale që është mbrojtja e tezës së diplomës.

Për të fituar të drejtën e mbrojtjes së temës së diplomës, studentit i **duhet**:

- a. të ketë fituar të gjitha kreditet;
- b. të ketë paraqitur në kohën e duhur projekt-propozimin e temës së diplomës;
- c. të ketë miratimin dhe vlerësimin nga udhëheqësi shkencor si garantues i cilësisë akademike të punimit të tij.

II. PËRCAKTIMI I UDHËHEQËSIT

Punimi i diplomës bëhet nën drejtimin e një punonjësi mësimor-shkencor të Departamentit të Menaxhimit, që kanë titull ose gradë shkencore (së paku Master). Udhëheqësit e temave të diplomës miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit. Përzgjedhja e temës bëhet nga studenti në bashkëpunim me udhëheqësin, brenda muajit dhjetor të semestrit të parë, të vitit të tretë të studimeve. Departamenti përcakton listën e temave të diplomave në fillim të semestrit të parë, të vitit të tretë të studimeve. Ky përcaktim bëhet duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon departamenti. (Shih Shtojca)

Departamenti brenda afateve të caktuara, u sugjeron studentëve që të tregojnë preferencat e tyre në lidhje me fushën si dhe pedagogun udhëheqës. Përgjegjësi i Departamentit, bazuar edhe mbi preferencat e studentëve përcakton listën e studentëve, me temat përfundimtare si dhe pedagogët udhëheqës. Më pas, kjo u bëhet e ditur studentëve. Studenti, nëse e sheh të arsyeshme, mund të kërkojë ndërrimin e udhëheqësit brenda një afati të përcaktuar nga Përgjegjësi i Departamentit. Kur për arsye të ndryshme, studenti ndërron mendim për mbrojtjen e punimit të diplomës ose pedagogu udhëheqës nuk ka mundësi që ta drejtojë atë, Përgjegjësi i Departamentit bën ndryshimet përkatëse.

Punimi i diplomës përgatitet individualisht nga çdo student ose në grup deri në tre studentë. Ndarja dhe përbërja e grupeve duhet të raportohen pranë sekretarisë së Departamentit.

III. PËRGATITJA E PUNIMIT TË DIPLOMËS

Punimi i diplomës duhet të përfaqësojë një punim origjinal të studentit, ku të sintetizohen njohuritë e përfituara përgjatë viteve të studimit. Fusha e studimit të punimit duhet të përkojë me një problem aktual të ekonomisë shqiptare. Nëpërmjet punimit të diplomës, studenti duhet të tregojë se është i aftë:

- të sintetizojë njohuritë teorike dhe praktike të përfituara gjatë viteve të studimit;
- të aplikojë njohuritë e përfituara në fushën e përzgjedhur ose në një rast praktik studimi;
- të tregojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur;
- të komunikojë idetë e tij tek lexuesi;
- të tregojë aftësi për të kërkuar, përmbledhur dhe reflektuar në mënyrë logjike rreth materialeve të lexuara.

Punimi i diplomës duhet të ketë këto karakteristika:

- Tema e diplomës përfaqëson në radhë të parë punën individuale të studentit, pavarësisht rasteve kur punimi realizohet në grup studentësh;
- Tema e diplomës duhet të shkruhet me stil akademik, duhet të jetë konçize dhe të trajtojë një çështje konkrete, dhe duhet të përfaqësojë një punim origjinal;
- Tema e diplomës përfaqëson njohuritë dhe aftësitë specifike të studentit;
- Tema e diplomës dëshmon për aftësinë e studentit për të planifikuar dhe organizuar punën;
- Tema e diplomës kërkon aftësi të menduarit kritik dhe analitik.

Fazat e përgatitjes të punimit të diplomës paraqiten më poshtë:

- [1] Krijimi i grupeve të punës.
- [2] Përcaktimi i fushës së studimit. Përzgjedhja e temës së punimit.
- [3] Përgatitja e projekt propozimit dhe miratimi i tij nga udhëheqësi
- [4] Përcaktimi i metodologjisë së studimit. Mbledhja e informacioneve mbi fushën e studimit
- [5] Zhvillimi i punimit. Përgatitja e versionit final. Miratimi i udhëheqësit.
- [6] Mbrojtja e temës së diplomës përpara Komisionit dhe Vlerësimi



IV. UDHËZIME MBI STRUKTURËN E TEMËS SË DIPLOMËS

Ky punim presupozohet të përbëjë rezultatin e një studimi të thelluar të literaturës shkencore dhe vëzhgimit në praktikë, reflektim të përvojës personale të fituar gjatë formimit teorik dhe praktik dhe dhënie të përfundimeve dhe të sugjerimeve mbi argumentin e përzgjedhur nga vetë studenti.

[A] Tema dhe problematika: Punimi i diplomës duhet të trajtojë një çështje empirike që lidhet ngushtë me *tematikën që mbulon programin e studimit dhe me fushën profesionale* ku do të punojë studenti. Tema mund të jetë studim i një rasti ose studim krahasues që hyn thellë në problematikën e një rasti të veçantë studimi (“*case study*”) dhe: i) është studiuar pak ose aspak; ii) për të cilin gjykohet se literatura nuk është e mjaftueshme; iii) është çështje emergjente që del nga debati ose nga përvoja në terren (empirike). Ky lloj studimi nuk merr domosdoshmërisht përsipër të përmirësojë teori ose të hapë shtigje të reja teorike dhe të prezantojë modele të reja konceptuale;

[B] Metodologjia: Punimi nënkupton *testimin e një hipoteze* (parashtrimin e një hipoteze, e cila do të vërtetohet ose do të hidhet poshtë) nga studenti duke u bazuar në një proces induktiv dhe në një metodologji cilësore;

[1] Faqja e parë – Titulli i Punimit – Titulli i punimit duhet të paraqitet me shkronja kapitale, madhësia 16. Pjesa tjetër e tekstit është me madhësi 14. Të gjitha të dhënat janë të përqendruara në qendër. Punimi i diplomës duhet të mbajë firmën e studentit dhe të pedagogut udhëheqës. Firma vendoset përbri emrit përkatës në faqen e titullit.

  <p style="text-align: center;">UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” FAKULTETI I EKONOMISË</p> <p style="text-align: center;">[TITULLI I PUNIMIT]</p> <p style="text-align: center;">TEMË DIPLOME</p> <p style="text-align: center;">PROGRAMI I STUDIMIT BACHELOR NË MENAXHIM</p> <table style="width: 100%;"><tr><td style="text-align: center;">Punoi: [Emri i Studentit]</td><td style="text-align: center;">Udhëheqës shkencor: [Emri i pedagogut]</td></tr></table> <p style="text-align: center;">Korçë, (viti)</p>	Punoi: [Emri i Studentit]	Udhëheqës shkencor: [Emri i pedagogut]
Punoi: [Emri i Studentit]	Udhëheqës shkencor: [Emri i pedagogut]	

[2] Faqja 2 – Abstrakti – Është në një faqe të veçantë dhe përfshin deri në tre paragrafë mbi temën, problematikën, pyetjen kërkimore, argumentin kryesor, si dhe bazën teorike e metodologjike të punimit. Abstrakti duhet të jetë rreth 300 fjalë.

[3] Faqja 3 – Dedikimi dhe Falënderimet – Ky element është krejtësisht opsional dhe nuk përfshihet në lëndën e temës. Këtu mund të përfshihen falënderimet për ndihmën akademike, kërkimore, logjistike e personale, që persona të caktuar i kanë dhënë studentit/es gjatë procesit të shkrimit të punimit të diplomës.

[4] Faqja 4 – Përmbajtja e punimit – Ky element nuk është opsional. Përmbajtja duhet të përfshijë në mënyrë të detajuar titujt e kapitujve, nëntitujt dhe seksioneve të çdo kapitulli si dhe numrat e faqeve në të cilat fillojnë. Titujt, nëntitujt dhe titujt e seksioneve duhet të dallohen nga njëri-tjetri.

[5] Faqja 5 – Lista e tabelave, figurave dhe formulave (nëse ka).

[6] Faqja 6 – Lista e shkurtimeve (nëse ka).

[7] Punimi i diplomës – Punimi duhet të organizohet sipas pjesëve:

Hyrja (2 faqe A4)

Skeleti teorik + modeli analitik i temës (3 faqe A4)

Argumentet dhe analiza e të dhënave (30 faqe A4)

Konkluzionet; Rekomandimet* (5 faqe A4)

Bibliografia**

* Në këtë pjesë do të përmbliidhen rezultatet dhe rekomandimet kryesore të argumentuara të studimit tuaj.

** Një punim diplome pa listë referencash do të konsiderohet i papranueshëm për t'iu nënshtruar vlerësimit. Bibliografia duhet të fillojë në faqe të re dhe të jetë në bazë të rregullave të shkrimit akademik, pra sipas rendit alfabetik të mbiemrit të autorit.

V. UDHËZIME MBI FORMATIMIN E PUNIMIT TË DIPLOMËS

Punimi shkruhet në gjuhën shqipe, në fletë A4. Titulli i çdo kapitulli është Times New Roman, font 14, në Bold. Numri i kapitullit jepet përpara titullit të kapitullit me shkronjë romake. Shkrimi i tekstit të punimit (përveç titujve) duhet të jetë font 12, në Times New Roman dhe me hapësirë 1.5 mes rreshtave.

Tema duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme:

- Punimi i diplomës duhet të ketë një gjuhë të kuptueshme dhe të rregullt, pa fraza të stërzgjatura dhe duhet të shkruhet në vetën e tretë.

- Tema duhet të shkruhet detyrimisht sipas rregullave gramatikore të gjuhës Shqipe, pa anashkaluar përdorimin e gërmave “ë” dhe “ç”)
- Punimi duhet të përmbledhet optimalisht në 40-50 faqe Word-i.
- Punimi duhet të punohet sipas rregullave të mëposhtme:
 - Fleta e punës A4, me përmasa klasike (2.5 në çdo anë).
 - Hapësira midis rreshtave: 1.5.
 - Stili i shkrimit: Times New Roman për të gjithë tekstin.
 - Madhësia e shkrimit:
 - 24, Bold për titullin kryesor të punimit;
 - 20, Bold, për nëntitullin kryesor të punimit;
 - 14, Bold, për titullin e kapitullit;
 - 12, Bold për titujt dhe nëntitujt e pjesëve të punimit;
 - 12 – Për tekstin e punimit;
 - 12, Bold, Italics për titujt e Tabelave dhe Figurave
 - Numrat e faqeve duhet të vendosen në fund të fletës, djathtas, duke filluar që nga faqja e dytë (faqja e Copyright). Numërimi i faqeve do të bëhet me numra arabike (1, 2, 3, etj)
 - Në kokën (Header) e secilës fletë (përveç faqes së parë të titullit) duhet të shënohet titulli i Temës (majtas) dhe Programi i studimit (djathtas).
 - Numërimi i kapitujve do të bëhet me numra romakë (I, II, III, IV, etj.)
 - Numërimi i çështjeve brenda kapitujve do të kryhet me numra romake, sipas shembullit: Çështjet e kapitullit I: I.1, I.2, etj.; Çështjet e kapitullit II: II.1, II.2, etj., e kështu me radhë.
 - Titujt: Hyrja, Metodologjia, Rishikimi i Literaturës, Përfundime dhe Rekomandime, dhe Referenca nuk do të numërohen, por thjesht do të ndiqet formatimi i sipërshtuar.
 - Në fund të çdo table dhe figure duhet të citohet burimi i përfundimit të informacionit në fjalë.
 - Titujt e Tabelave do të shënohen sipër tabelës.
 - Titujt e Figurave do të shënohen nën figurë.
 - Numërimi i Tabelave dhe Figurave do të bëhet me numra arabikë dhe duhet të përputhet me numrin e kapitullit. Pra, në kapitullin 1 figurat dhe/ose tabelat duhet të numërohen 1.1, 1.2, 1.3, etj., në kapitullin 2 figurat dhe/ose tabelat duhet të numërohen 2.1, 2.2, 2.3, etj., e kështu me radhë.
- Referencat duhet të shënohen përgjatë tekstit. Një shembull i referencave në tekst është:
Decentralizimi fiskal ndikon pozitivisht në varfëri (Bahl, 2003 fq.54).

Në këtë rast stili i përdorur është (Autor, Datë), por gjithashtu mund të përdoret edhe stili Footnote, por asnjëherë të dyja së bashku. Nëse përdoren citime fjalë për fjalë, pra citime direkte, duhet të përdoren thonjëza për shprehjen e kopjuar dhe duhet vendosur në fund të citimit direkt referenca përkatëse e autorit, viti i botimit dhe numri i faqes në punimin origjinal.

- Të gjitha referencat e përdorura përgjatë tekstit duhet të përmbliidhen në fund, tek Bibliografia. Disa shembuj të referencave sipas tipit të materialit të gjetur paraqiten më poshtë:

Monografi: Mbiemri i autorit, Emri. (Viti). Titulli i librit. Qyteti i publikimit: Botuesi.

Kapitull: Mbiemri i autorit, Emri. (Viti). “Titulli i kapitullit ose artikullit.” In: ed. dhe emri i editorit nëse duhet. Titulli i Librit, ndjekur nga, Qyteti i publikimit: Botuesi (Emri i Serisë dhe Numri i vëllimit nëse mundet), dhe numrat e faqeve.

Faqe interneti: Emri i Autorit/Web Site-it (Viti): Titulli. URL (data e aksesit).

Disa shembuj referencash: janë si më poshtë:

1. Drucker, Peter. (1993). *Managing in Turbulent Times*. New York: Harper & Row.
2. Bahl, Roy and Jorge Martinez-Vazquez. (2005). “*Fiscal Decentralization and Economic Reform in China.*” In: T.S. Srinivasan and Jessica Wallack, eds., *The Dynamics of Federalism: The Political Economy Reality*, Oxford Economic Press.
3. Gutman, Graciela. (2002). Impact of the rapid rise of supermarkets on dairy products systems in Argentina. *Development Policy Review*, 20(4), pp. 409–427.
4. Eurostat (2009). Government indicators; URL:
<http://epp.eurostat.ec.europa.eu/tgm/refreshTableAction.do?tab=table&pl>
(referuar më 20.01.2019)

VI. DORËZIMI I TEMËS SË DIPLOMËS

Diplomimi bëhet në sezonin e verës (Korrik) dhe në sezonin e vjeshtës (Shtator). Tema e diplomës dorëzohet një muaj përpara datës së mbrojtjes. Studentët, të cilët nuk respektojnë këto afate ose nuk kanë marrë 173 kredite, nuk mund të bëjnë mbrojtjen e temës në sezonin e përcaktuar.

Brenda këtij afati studenti duhet të dorëzojë në sekretarinë e Departamentit:

- a. tre kopje të printuara dhe të lidhura të punimit të diplomës;
- b. materialin në Power Point që do të prezantojë para Komisionit në datën e mbrojtjes.

Komisioni i Vlerësimit krijohet nga Dekani i Fakultetit dhe përbëhet nga të paktën tre anëtarë. Detyrat e komisionit janë si më poshtë:

1. Të dëgjojë brenda kohës së përcaktuar referimet e studentëve, të organizojë pyetje dhe diskutime që përcaktojnë më qartë cilësinë e punës së studentit, veçanërisht kur puna është bërë në grupe;
2. Të vlerësojë shkallën e përgatitjes së studentit;
3. Të vlerësojë me Notë punimin e diplomës.

Mbrojtja e temës së diplomës përpara Komisionit është e hapur. Studenti që merr notë jokaluese në sezonin e parë të mbrojtjes së diplomës ka të drejtë të paraqitet për mbrojtje në sezonin e ardhshëm. Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur mikrotezën, pajiset me diplomën përkatëse, e cila i jepet atij së bashku me “Shtojcën e Diplomës” (Diploma Supplement).

VIII. ORGANIZIMI I MBROJTJES SË TEMËS SË DIPLOMËS

Temat do të prezantohen me Power Point dhe studentët do të kenë maksimumi 15 minuta kohë në dispozicion për prezantimin e punimit të tyre (studentët duhet të përgatisin afërsisht 15-20 slide). Studentët duhet të mbajnë në konsideratë që gjatë prezantimit të përqëndrohen në pikat më kryesore të punimit të tyre. Në slide duhet të pasqyrohet qartësisht: përmbajtja, qëllimi, metodologjia dhe konkluzionet e punimit. Slide i parë duhet të përmbajë: stemat e Universitetit “Fan S. Noli” dhe Fakultetit të Ekonomisë, titullin e punimit, emrin e studentit dhe emrin e udhëheqësit. Në fund të prezantimit anëtarët e komisionit mund ti drejtojnë studentit pyetje dhe të bëjnë komente mbi punimin e diplomës.

Kur përfundon prezantimi i fundit i punimeve, komisioni tërhiqet për të bërë vlerësimin përfundimtar. Komisioni bën vlerësimin e punimit të diplomës mbështetur tek:

- punimi i paraqitur në formë të shkruar e të lidhur (dobia e punimit & zbatimi praktik);
- prezantimi i punimit nga ana e studentit gjatë mbrojtjes para komisionit;
- pëgjigjet e studentit ndaj pyetjeve të komisionit;
- vlerësimin e reçencës dhe mendimin e udhëheqësit të temës;
- mesatarja e tre viteve të studimit në programin e studimit të ciklit të parë.

Kryetari i Komisionit bën shpalljen e rezultateve përfundimtare për secilin student.

Përgatitja e këtij udhëzuesi u mbështet në rregulloren e studimit të programit të studimit Menaxhim, Bachelor, të Departamentit të Menaxhimit, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.

Udhëzuesi për përgatitjen dhe mbrojtjen e Temës së Diplomës, 2019-2020, për studentët e programit të studimit Menaxhim, Bachelor, u miratua në mbledhjen e Departamentit të Menaxhimit të datës 23. 09. 2019.

U D H Ë Z U E S

**Për përgatitjen dhe mbrojtjen e Temës së Diplomës
në përfundim të ciklit të parë të studimit**

PROGRAMI I STUDIMIT "MENAXHIM"

BACHELOR



Universiteti "Fan S. Noli"
FAKULTETI I EKONOMISË

**Fakulteti i Ekonomisë
Universiteti "Fan S. Noli"
Shëtitore "Rilindasit", 7001
Korçë, SHQIPËRI**

Tel/Fax: +355 82 242201

Web site: <http://www.unkorce.edu.al>